



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 10 mars 2011  
Nr. ref.: RK95/11

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI 49/10**

Parashtruesi i kërkesës

**Abdullah Shkodra**

**Shqyrtim kushtetues i Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit, AC. nr.  
70/2010, të datës 15 prill 2010**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Abdullah Shkodra, me banim në Gjilan.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar nga parashtruesi i kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit, Ac. nr. 70/2010, i datës 15 prill 2010.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi i kërkesës pohon se me rastin e përmbarimit të marrëveshjes së huas, të lidhur mes tij dhe kreditorit, gjykatat e rregullta nuk e kanë marrë parasysh faktin se (1) ai ka bërë marrëveshje gojore me kreditorin që të mos e paguajë huan në tërësi për shkak të problemeve financiare, dhe (2) se kreditori nuk i ka regjistruar pagesat tanimë të bëra nga ai. Parashtruesi i kërkesës e bazon pretendimin e tij me faktin se kreditori nuk ia ka mundësuar shtyrjen e afatit të pagesës së huas.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 22 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura para Gjykatës**

5. Më 28 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 26 korrik 2010, parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën se ai kishte marrë një shkresë nga Gjykata Komunale e Gjilanit të datës 20 korrik 2010, në lidhje me rastin E. nr. 764/2009, me të cilën ai njoftohej se ishte emëruar një ekspert për të rivlerësuar vlerën e patundshmërisë së tij të vënë në hipotekë. Mirëpo, parashtruesi i kërkesës e vë në pikëpyetje objektivitetin e ekspertit, pasi që ai jeton në të njëjtën lagje ku jeton edhe gjyqtari në rastin e tij. Prandaj, ai kërkon emërimin e një eksperti që do ta rivlerësojë patundshmërinë e hipotekuar në mënyrë të drejtë dhe objektive.
7. Më 25 gusht 2010, kërkesa i është dërguar Gjykatës së Qarkut të Gjilanit.
8. Më 22 tetor 2010, parashtruesit të kërkesës iu kërkuan dokumente dhe sqarime shtesë, të cilat ai i ka paraqitur më 1 nëntor 2010.
9. Më 5 nëntor 2010, dokumente shtesë iu kërkuan Gjykatës Komunale dhe Gjykatës së Qarkut të Gjilanit, të cilat deri më tani nuk janë dorëzuar.
10. Më 20 janar 2011, Kolegji shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalovič dhe Enver Hasani, e shqyrtuan raportin e Gjyqtarës raportuese, Iliriana Islami, dhe i rekomanduan Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve**

11. Më 31 mars 2004, kompania e parashtruesit të kërkesës, "Mimoza-Commerce" (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi i kërkesës), bëri marrëveshje për hua në shumë prej 50.000 € me një bankë komerciale (në tekstin e mëtejme: Kreditori) për një periudhë dymbëdhjetë mujore.

12. Më 17 maj 2005, Gjykata Komunale e Gjilanit e lejoi kreditorin që të zbatonte pikën e përmbarimit, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk e kishte respektuar atë marrëveshje, dhe më 31 korrik 2007 e emëroi një ekspert për të vlerësuar vlerën e patundshmërisë së hipotekuar të parashtruesit të kërkesës.
13. Më 16 maj 2008, Gjykata Komunale e Gjilanit e caktoi çmimin e tregut të patundshmërisë së hipotekuar të parashtruesit të kërkesës në bazë të vlerësimit të ekspertit.
14. Parashtruesi i kërkesës u ankua në lidhje me çmimin e tregut në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit, e cila me vendimin e datës 11 shtator 2008 e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë e kishte zbatuar në mënyrë korrekte të drejtën materiale dhe procedurale.
15. Më 16 nëntor 2009, parashtruesi i kërkesës parashtrroi një kërkesë në Gjykatën Komunale të Gjilanit për kthim në gjendjen e mëparshme, e cila më 15 dhjetor vendosi që kërkesa e parashtruesit nuk mund të miratohet, pasi që neni 14.2 i Ligjit për procedurën përmbarimore parasheh që kthimi në gjendjen e mëparshme të jetë i mundur vetëm në rast të (1) mosrespektimit të afatit kohor për parashtrimin e kundërshtimit dhe në rast të (2) ankesës ndaj vendimit të ekzekutueshëm për përmbarim obligativ, gjë që nuk ka ndodhur me këtë çështje.
16. Më tutje, Gjykata Komunale theksoi se “debitori e parashtrroi kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme më 16 nëntor 2009, pra, në një periudhë kur seanca për përmbarimin e konkluzave në ankandin e parë publik u mbajt me kërkesë të kreditorit për përmbarim më 13 nëntor 2009, dhe sipas vendimit procedural të nxjerrë më 13 nëntor 2009, pasi që nuk ka pasur ofertues për blerjen e hipotekës, në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurën përmbarimore u vendos që të mbahet ankandi i dytë publik”.
17. Parashtruesi i kërkesës u ankua ndaj vendimit të Gjykatës Komunale të datës 15 dhjetor 2009, në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, e cila më 15 prill 2010 e hodhi poshtë ankesën si të pabazuar duke përsëritur të gjeturat e Gjykatës Komunale. Më tutje, Gjykata e Qarkut theksoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur dëshmi se kishte arritur marrëveshje gojore me kreditorin për kthimin e huas.
18. Më 16 korrik 2010, Gjykata e Qarkut në Gjilan e emëroi ekspertin për vlerësimin e vlerës së patundshmërisë së hipotekuar.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon të ketë arritur marrëveshje gojore me kreditorin se nuk do të ketë nevojë ta paguajë huan në tërësi për shkak të problemeve të tij financiare. Për më tepër, ai pohon se kreditori nuk i ka regjistruar pagesat e bëra nga ai.
20. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu i referohet faktit se kreditori është dashur t'ia mundësojë shtyrjen e afatit të pagesës së huas.
21. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat dhe kreditori nuk e kanë marrë parasysh interesin e tij kur kanë bërë përlllogaritjen e vlerës së pronës së hipotekuar dhe të marrëveshjes gojore që ai e kishte arritur me kreditorin.

## Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.*

24. Sipas kushtetutës, Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt me rastin e shqyrtimit të vendimeve të gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

25. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse dëshmitë janë paraqitur në atë mënyrë, dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në atë mënyrë që parashtruesit të kërkesës i është bërë gjykim i drejtë (shih, mutatis mutandis, Raport i Komisionit Evr. për të drejtat e njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

26. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar dëshmi, prima facie, që do tregonin se cilat të drejta dhe liri ai pretendon t'i jenë shkelur dhe cili akt konkret i autoriteteve publike sfidohet, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit (shih Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të datës 31 maj 2005).

27. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhje me rregullin 36 (1. c) të Rregullores së punës, e cila parasheh:

*“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c)kërkesa është qartazi e bazuar”.*

## PËR KËTË ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit, dhe rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës, njëzëri

## VENDOS

I. **TA HEDHË POSHTË** kërkesën si të papranueshme.

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja Raportuese

Dr. Iliriana Islami



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani